

## Komisioni European adopton Programin Kombëtar për Shqipërinë, IPA 2008

Me 19 Dhjetor 2008, Komisioni Evropian miratoi Programin Kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e komponentit Asistenca e Tranzicionit dhe Ngritja Institucionale e IPA 2008. KE do t'i japë Shqipërisë asistencë financiare deri në 60,917 milion EUR për të mbështetur reformat, të cilat do të sigurojnë një financim me vlera maksimale deri në € 60,917,000, në drejtim të zhvillimit të reformave kryesore në vënd.

Ky program konsiston në 24 projekte

mbështetese të procesit të reformave politike dhe ekonomike në Shqipëri, si dhe në asistencën për të plotësuar standartet europiane. Projektet në fushën e politikës përfshijnë forcimin e kapaciteteve administrative, ngritja dhe përmirësimi i qendrave të burgimit dhe paraburgimit, modernizimin e procedurave doganore dhe luftën kundër korrupsionit. Në fushën ekonomike, ky program konsiston në asistencë të sistemit të trajnimit dhe edukimit profesional, përmirësimin e

rrugëve dytësore dhe lokale si dhe promovimi i rajoneve kufitare në zonën e Kukësit. Financim është parashikuar edhe në lidhje me sektorin e marines, ruajtjen publike ndaj sëmundjeve me prejardhje nga kafshët, përmirësim të sistemit monitorues të mjedisit, si dhe një projekt me qëllim përmirësimin e rrugëve kryesore në Shqipëri. E fundit por jo përfundimtare, ky program do financojë pjesëmarrjen e Shqipërisë në Programet e Komunitetit.



Ambasadori Helmuth Lohan, Ministria e Integritit European Majlinda Bregu dhe Dirk Lange, Komisioneri European për Zgjerimin. Takimi parapergatitor për programin IPA. Dhjetor 2008

### Prioritetet

Program IPA 2008 për Shqipërinë fokusohet në objektiva të përcaktuara nga Dokumenti i Planifikimit Multi-Vjeçar 2008-2010. 24 projektet e këtij programi janë të grupuara nën 4 shtylla strategjike. Asistenca e ofruar nga ky program bazohet në rekomandimet e Progres Raportit mbi Strategjinë e Zgjerimit të 2007, si dhe

prioriteteve të Partneritetit European të përcaktuara në detyrimet e MSA.

IPA 2008 do ju adresohet çështjeve të rëndësishme siç janë reforma në administratën publike si dhe në forcat e rendit, dhe në mënyrë më specifike në masat e ndermarra kundër korrupsionit dhe mirëqeverisjes. Kjo reflektohet në rritjen e fondeve të alokuara në fushën e plotësimit të kërkesave politike nga Ministria e Punëve të

Brëndshme për 2008-2010. Një prioritet i lartë i është dhënë forcimit të kapaciteteve administrative nën kuadrin e implementimit të MSA dhe mbështetjes së autoriteteve Shqiptare në plotësimin e detyrimeve të kësaj marrëveshjeje..

Vihet re nevojja për mbështetje të mëtjetshme të procesit të reformimit në vënd, investimit në infrastrukturë, vecanërisht në zonat në zhvillim.

## Kriteri Politik

31% e të gjithë buxhetit të Programit 2008 do shkojë në këtë fushë. IPA do të asistojë reformat aktuale në administratën publike nëpërmjet institucioneve të përfshira në menaxhimin e shërbimit civil, kryesisht në Departamentin e Administratës Publike. Me qëllim përmirësimit e kapaciteteve administrative, kjo asistencë do i afrohet në tërësi të gjitha strukturave bashkëpunuese në menaxhimin e procesit të MSA, në vecanti Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Asistencë e mëtejshme do i sigurohet mirëqeverisjes në lidhje me masat e ndërrmarra në luftën kundër korrupsionit dhe forcimit të menaxhimit të fondeve publike, në vecanti sistemit të Thesarit dhe prokurimeve publike.. IPA gjithashtu do të kontribuojë në përafërsimin e procedurave doganore me standartet europiane. Mbështetja ndaj sistemit gjyqësor do sigurohet nëpërmjet ngritjes së qendrave të parburgimit në Shkodër. Projekti do asistojë autoritetet në hartimin e programeve të mëtejshme si dhe të ushtrimeve trajnuese

## Kriteri social-ekonomik

26% e buxhetit të përgjithshëm të

### Asistencat e shkuara si dhe ato që janë në implementim e sipër.

Në periudhën 2001- 2006 Shqipëria ka përfituar rreth 330 million EUR nga asistencat e CARDS . CARDS ka përcaktuar 4 fusha të gjëra prioritare: drejtësia dhe punët e brendshme ( i është dhënë rreth 40% e fondeve) ngritja e kapaciteteve administrative ( rreth 20%) zhvillimi ekonomik-social ( rreth 35%) dhe stabilizimi demokracisë ( rreth 5%) Me naxhimi i projekteve të Komisionit Europian i është transferuar Delegacionit Europian në Tiranë , gjithmonë nëpërmjet programit CARDS. Delegacioni punon në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë Shqiptare të Integritimit Europian. Mbështetja e siguruar nëpërmjet CARDS gjatë 2005/2006 dhe IPA 2007 vazhdon të implementohet dhe është pjesë e projekteve mbështetëse në fushën e mirëqeverisjes, forcimit të ligjit, shoqërisë civile, arsimit, punësimit, Standarteve Europiane, zhvillimit rajonal, transportit, mjedisit, bujqësisë, zhvillimit rural, Forcimit të Ministrisë së Integritimit Europian, statistikave dhe taksave. Programi Kombëtar IPA 2007 i adresohet : reformave në polici, decentralizimit dhe menaxhimit të asistencës si dhe infrastrukturës së burgjeve. Në fushën e kritereve ekonomike, ky program kombëtar i 2007 i adresohet Forcimit të Ministrisë së Integritimit zhvillimit dhe

programit 2008 do alokohet në fushën social-ekonomike. Do mbështeten strukturimi i mëtejshëm i reformave në vënd në fushën e infrastrukturës, duke bërë të mundur kontribuimin në kohësinin dhe zgjerimin ekonomik të vëndit. IPA do të mbështeti përmirësimin e kushteve dhe menaxhimit të rrugëve secondare dhe lokale dhe të implementimit të Strategjisë Kombëtare të Arsimit me fokus up-gredimin e Shkollave profesionale dhe Trajnuese DG ELARG ka vendosur të transferojë fonde të IPA-s prej Komponentit II tek Komponenti I, në mënyrë që të mundësohet vazhdimi i programit të zhvillimit kufitar unilateral për rajonin e Kukësit.

### Mundesia për të marrë përgjegjësi dhe të vihen në zbatim obligimet e anëtarësimit.

40% e buxhetit të programit 2008 do të alokohet venies në zbatim të detyrimeve të antarsimit . IPA do mbështeti dhe asistojë Shqipërinë në përafërsimin me standartet e BE, përfshirë këtu kapacitetet administrative dhe plotësimin e detyrimeve të MSA sic janë të drejtat e autorit, metrologjia, konkurrenca, ndima sociale dhe aviacioni civil. Gjithashtu do asistohet edhe Banka e Shqipërisë.

përafërsimit të standarteve Europiane duke përfshirë projekte asistencë në lidhje me statistikën, furnizimin me ujë të pijshëm sistemit të ujërave të zeza dhe taksave. Buxheti total i fondeve të alokuara për 2007 shkon në 49.2 milion EURO Shqipëria ka përfituar edhe nga aktivitetet rajonale nën kuadrin e CARDS, të cilat kanë mbështetur veprime me interes të përbashkët për rajonin e Ballkanit Perëndimor, në fushat e infrastrukturës, ndërtimit të institucioneve dhe bashkëpunimit nderkufitar. Këto aktivitetet rajonale të IPA-S mbulojnë nga programe Multi-beneficiare në lidhje me reformat administrative, drejtësinë dhe punët e brendshme, shoqërinë civile, rininë, arsimin, kerkimeve infrastrukturës, tregut të brendshëm dhe sigurisë nukleare.

### Asistencat e Komisionit Europian ndaj Shqipërisë për (1991-2007) kap shifra në miliona Euro

IPA	61
CARDS	330
Phare	635
Macro-financial assistance	150
ECHO	142
EIDHR	5
Total	1323

Përsa i përket politikave sektoriale, IPA, do mbështeti strategjitë për zhvillimin e zonave rurale dhe strukturave të tjera të njëjta, monitorimin dhe kontrollin e sistemeve si psh ( peshkimit), menaxhimin e sistemit të monitorimit të mjedisit dhe kontrollit të sëmundjeve tek kafshët. Asistencë do të ofrohet edhe në fushat e transportit inter-urban, trans-urban, autostradave dhe portit të Shëngjinit.

### Pjesmarrja në Programet e Komunitetit.

2% e buxhetit të përgjithshëm të programit 2008 do i alokohet kësaj fushe. Pjesmarrja në programet e Komunitetit parashikon: CIP, FP7 dhe Europa për qytetarët. Kontributi i Komunitetit Europian nëpërmjet IPA-s përfaqëson 90.6% të buxhetit total ose (ca. € 67.2 milion) të cilat i alokohen këtij programi. Donatorët të tjerë përfshi këtu edhe Shqipërinë do sigurojnë bashkëfinancim për 9 nga 24 projektet e programit..

Një analizë e përgjithshme e programeve të asistencës të ( BE/ IFI/ Bilaterale) në të shkuarën dhe ato që janë akoma në vazhdim, përfshijnë edhe koordinimin me donatorët.

### Mësimet e nxjerra

Vlerësimi i brëndshëm (Phare 1999-2002) si dhe ai i mëparshëm (Phare 1999-2001) mbi programet e asistencës së BE, ka identifikuar pikat që duhet të merren parasysh në lidhje me programet e asistencës në të ardhmen. Eksperiencat e marra gjatë implementimeve të programeve të asistencës të CARDS dhe IPA si dhe nga raportet vlerësuese të DG ELARG, dhe me specifikisht , raportit vlerësues mbi reformat në administratën publike , sugjerojnë që programi i asistencës së IPA, duhet të marrë në konsideratë mësimet e nxjerra si më poshtë:

Pronesia lokale është esenciale për sa i përket shkëmbimit të asistencës dhe arritjes së rezultateve të përcaktuara. Deri tani janë ndërmarrë përpjekje sinjifikative në përfshirjen e institucioneve Shqiptare në procesin e programimit për asistencë nga BE. Ministria e Integritimit Europian, ka përfituar shumë në lidhje me mbështetjen ndaj forcimit institucional dhe të kapaciteteve. Prezantimi i Programit të Punonjësve të Lartë si pjesë e Integritimit Europian në linjë edhe me ministrinë e tjera , si dhe roli udhëheqës që ka marrë Ministria e Integritimit Europian , në procesin e programimit, do sigurojë mundësinë për përcaktimin dhe identifikimin e nevojave për asistencë

Duhet siguruar kapacitetet absorbuese të autoriteteve. Kjo varet nga



maturia e projektit, nje staf sa me adekuat i institucioneve relevante si dhe mobilizimi i shoqërisë civile dhe të një konsensusi politik në lidhje me reformat kyce.

Planifikimi ne kohë në lidhje me programet e asistencave për të ardhmen, eshte thelbësor në përcaktimin dhe adresimin e fushave me kryesore. Duke marrë parasysh vonesat ne implementimin e programeve te CARDS dhe IPA , duhet te sigurohemi qe keto projekte të mos kthehen ne pengesa për shkak te vonesave në implementim.

Duhet të sigurohet nje lidhje më funksionale mes Asistencës se BE, strategjive sektoriale dhe planeve te veprimit te Institucioneve Shqiptare.

Qëllimi i gjithë kësaj është dizajnimi i programeve të asistencës në lidhje me planet strategjike për Shqipërinë, dhe zbatimi dhe plotësimi i detyrimeve të procesit të integrimit..

Një vëmëndje e vecantë i duhet kushtuar përgatitjes dhe rëndësisë së projekteve të përzgjedhur..

**Kushtet**

Programi konsiston në kushtëzimet e mëposhtme: Projektete aprovohen formalisht me ane të shkëmbimit të korrespondencës mes Komisionit dhe qeverise Shqiptare..

Qeveria duhet tju sigurojë institucioneve beneficiare risurset e nevojshme

financiare, materiale dhe njerzore, në mënyrë që mbështetja financiare e BE të përdoret në mënyrën më efikase të mundshme.

Institucionet beneficiare duhet te zbatojnë zyrtarisht dizainin, dokumentat e tenderit , duke perfshire edhe termat e references

Institucione beneficiare organizojnë, përzgjedhin dhe emërojnë anëtarët ( duke pasur parasysh gjininë dhe përkatësitë etnike) e grupeve të punës, të komiteteve koordinuese dhe drejtuese, si dhe të seminareve sipas aktiviteteve të përcaktuara në project. Kushtezimet specifike janë të shpjeguara ne anekset e projektit. Në rastin e moszbatimit të këtyre kushteve, merret në konsideratë, pezullimi apo anulimi i projektit.

# BE financon projektin për burgjet dhe qendrat e reja të paraburgimit në Shqipëri

Gjatë muajit Dhjetor 2008 Shefi i Delegacionit të Komisionit Europian në Tiranë, Ambasadori Helmuth Loohan, vizitoi ambientet e qendrës së re të trajnimit të administratës së re të burgjeve në Fushë-Krujë. Kjo qëndër është pjese e projektit 400.000 euro të asistencës së BE mbi " Menaxhimin e Burxheve me mënyra më njerzore". Ky project ofron trajnim mbi të drejtat e të burgosurve, si dhe ofron ndimë me organizimin e strukturave të burxheve, menaxhimin e konflikteve në këto qendra, si dhe respektimin e një kodi sjelljeje nga stafi i këtyre qën-

drave. Të gjitha këto çështje do të paraqiten në manualin " Funksionimi i Standarteve", publikim i projektit.. Ky është një pjese e asistencës të ofruar nga BE ndaj Sistemit Gjyqësor dhe te Burxheve në Shqipëri. Burgu i Fushë-Krujës u ndërtua nga një project prej 3.8 milion euro. Kjo qëndër ofron akomodim për 312 të dënuar, prej të cilëve 176 të dënuar në qëndër të sigurisë së ulët dhe 136 të cilët duhet të kryejnë dënimin në një qëndër të sigurisë së lartë. Janë ndërtuar edhe disa qendra të tjera burgimi dhe paraburgimi sic jane ajo e Korces dhe një qëndër paraburgimi në Vlorë. Është në ndërtim një qëndër rehabilitimi për të rinjtë në Kavajë. Ndërtimi i këtyrë qendrave të reja siaps standarteve Europiane, ndimon në uljen e mbipopulimit të burgjeve dhe qendrave të paraburgimit në Shqipëri sic u raportua edhe ne Progres Raportin

ofrojne mundësi e përgatitjes se të dënuarve për një kthim në shoqëri. Një çështje tjetër e rëndësishme eshte trajtimi i të dënuarvë nga stafi i këtyre qendrave. Infrastruktura e re e këtyre qendrave ofron edhe një program të përshtatshëm aktivitetesh pëe të dënuarit. Ekspertiza dhe trajnimi i ofruar nëpërmjet projektit " Menaxhimi i Burgjeve me Metoda Njerzore" do të rrisë kapacitetet e stafit të qendrave te burgimit dhe paraburgimit Fushë Krujës, Vlorësdhe Korçës, duke krijuar kshu një klimë më të sigurt brënda këtyre institucioneve.



Ambjentet e Burgut në Fushë - Krujë

Gjate fjalës së tij, Ambasadori Loohan ju referua festimit të 60 vjetorit të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut. Ambasadori theksoi se . respektim i it ë drejtave të njeriut përbën një nga principet fundamentale të Bashkimit Europian. Projekti mbi : Menaxhimin e Burgjeve me Metoda më Njerzore" është implementuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në bashkëpunim edhe me Agjencine Hollandeze të Institucioneve të Denimit.



2008 për Shqipërine. Asistenca e BE në këtë fushë kap shifrën €10 milion. Hapja e qendrave të reja të burgimit ka rëndësi e vet por nuk mjafton në zgjidhjen e problemit. Burgjet nuk duhet të shërbejne vetem si qendra për kryerjen e dënimit por duhet të

ofrojne mundësi e përgatitjes se të dënuarve për një kthim në shoqëri. Një çështje tjetër e rëndësishme eshte trajtimi i të dënuarvë nga stafi i këtyre qendrave. Infrastruktura e re e këtyre qendrave ofron edhe një program të përshtatshëm aktivitetesh pëe të dënuarit. Ekspertiza dhe trajnimi i ofruar nëpërmjet projektit " Menaxhimi i Burgjeve me Metoda Njerzore" do të rrisë kapacitetet e stafit të qendrave te burgimit dhe paraburgimit Fushë Krujës, Vlorësdhe Korçës, duke krijuar kshu një klimë më të sigurt brënda këtyre institucioneve.

# EU mbështet Këshillin e Lartë të Drejtësisë me një projekt asistence prej 700.000 euro



Takimi për Mbështetjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Dhjetor 2008

Me datë 18 Dhjetor 2008 në Tiranë u zhvillua ceremonia e mbylljes së projektit 700.000 euro, të financuar nga BE "Mbështetje për Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoriatin e tij". Ky projekt u implementua si një binjakëzim mes Këshillit të Lartë të Drejtësisë Shqiptare dhe Gjykatës së Lartë Italiane në partneritet edhe me Gjykatën e Lartë Spanjolle.

Lartë të Drejtësisë Shqiptare në lidhje me zhvillimin dhe implementimin e sistemit modern të përcaktimit të takimeve, transferimeve, promovimit, vlerësimit dhe inspektimit të gjykatësve, did he të përcaktimit të kompetencave të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrise së Inspektoriateve të Drejtësisë në lidhje me çështjet disiplinore

Ky projekt asistoi Këshillin e Lartë të Drejtësisë në përmirësimin e sistemit profesional të menaxhimit dhe të praktikave të punës me qëllim rritjen e efikasitetit, transparencës dhe gjykimit të drejtë të sistemit gjyqësor në Shqipëri. Ekspertët Italiane dhe Spanjoll bashkëpunuan me Këshillin e

U krijua një organizim i ri strukturës së brendshme të KLD, me metoda profesionale administrative dhe vendim-marrëse, të cilat kanë si qëllim rritjen e performancës, të profesionalizmit dhe pamvarësisë së këtij Këshilli. Gjykatësve dhe institucioneve të linjës ju dorëzua një manual me përmbajtje vlerësimet dhe aktet normative mbi çështje kryesore të trajtuara nga projekti.

Gjatë kësaj ceremonie Ambasadori Helmuth Lohan deklaroi "Prezenca e ekspertëve ndërkombëtar të fushave të ndryshme është një asistencë e cmuar e cila i ofrohet Shqipërisë nga BE me qëllim arritje të progresit në reformat e ndërmarra. Unë jam shumë i kënaqur që institucioneve shqiptare ju është dhënë mundësia të marrin dhe shkëmbejnë eksperiencë nga misionet e asistencës së BE me veprimtari në Tiranë"

## Zgjerimi, pjesë e planit të BE të mëkëmbjes.

Komisioni Evropian e shpreh solidaritetin me vendet potenciale për kandidat në BE me anë të një palni mëkëmbjeje nga krizat ekonomike. Komisioni ka ndare një pakete prej 120 milion euro si "Paketa për krizat" me qëllim mbështetjen e zhvillimit ekonomik, sidomos për kompanitë e vogla, si dhe një fond prej 500 milion eurosh që do përdoret si hua për institucionet financiare ndërkombëtare. Komisionieri Evropian për Zgjerimin Olli Rehan deklaroi se: Jam shumë i lumtur që Komisioni aprovoi dhe adoptoi një propozim të tillë kaq të rëndësishëm që tregon se vendet candidate nuk janë harruar. Kriza financiare ka treguar qartë se sa shumë është shaklla e integritetit të vendeve të Europës Jugore dhe Lindore në BE. Ekonomitë e reja të këtij rajoni përfaqësojnë ekonomitë më di-

namike në Europë, duke u kthyer në një destinacion kryesor për eksportin e mallrave Evropiane. Kjo tregon se zgjerimi nuk është më një problem, por krejt e kundërta, zgjerimi është pjesë e zgjidhjes për rigjallërimin e ekonomisë Evropiane. Ne ndajmë të njëjtin fat" Ky Plan ka si qëllim vazhdimësinë e "mbështetjes dhe konsolidimit ekonomik-social të vendeve kandidatë dhe të Ballkanit Perëndimor, në interes të përbashkët të BE dhe rajonit".



Ju lutem vizitoni faqet e internetit të poshtëshënuara ose kontaktoni Delegacionin e Komisionit Evropian në Tiranë  
[www.delalb.ec.europa.eu](http://www.delalb.ec.europa.eu)  
[www.europa.eu](http://www.europa.eu)  
[www.ec.europa.eu/enlargement](http://www.ec.europa.eu/enlargement)  
 Delegacioni i Komisionit Evropian në Tiranë, Shqipëri:  
**Rruga Durrësit, 127-1, Tirana, Albania**

Telefon: (355) 4 228320 or 230871 - 228479 - 234284 - 229851 Fax: (355) 4 230752 or 274412  
 e-mail: [Delegation-Albania@ec.europa.eu](mailto:Delegation-Albania@ec.europa.eu)  
 Botuesi: Komisioni i Delegacionit Evropian  
*Opinionet e shprehura në këtë botim nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpërvështrimin e Komisionit Evropian*  
 Nëse doni të merrni botimin e ardhshëm ju lutem na shkruani në adresën e-mail: [suela.thanasi@ec.europa.eu](mailto:suela.thanasi@ec.europa.eu)  
 ose kontaktoni Delegacionin e Komisionit Evropian